

TETOR 2005

Kërkesat kundër Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) dhe/ose ndonjë Ndërmarrje nën administrim të AKM në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/12 për Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, të ndryshuar me UNMIK Rregulloren 2005/18.

Pretenduesit potencial duhet të sigurojnë se i kanë marr parasysh të gjitha ligjet dhe rregulloret relevante me kujdes dhe se kanë marr parasysh pranimin e këshillave nga ekspertet ligjor në lidhje me çfarëdo ankese që mund të kenë ata ndaj AKM dhe/ose çfarëdo ndërmarrje nën administrim të AKM.

Ky dokument nuk ka fuqi të ligjit dhe nuk është asgjë më tepër sesa një përmbledhje e çështjeve specifike që duhet të merren parasysh nga ndonjë pretendues potencial. Ky dokument-përmbledhje, përnga definicioni, nuk është gjithpërfshirës dhe nuk i mbulon të gjitha fushat e ligjit dhe procedurat. Nuk është zëvendësim për rishqyrtim të ligjeve dhe rregulloreve, sidomos ato që janë te cekura në paragrafin 1 më poshtë. Pretenduesit potencial duhet të kenë konsideratë ndaj faktit se ky dokument nuk është juridikisht i detyrueshëm dhe nuk duhet të konsiderohet si këshillë juridike bazë.

SHËNIM I RËNDËSISHËM:

Ky dokument ka të bëjë me (i) **regjistrimin e kërkesave** dhe (ii) **fillimin e procedurës** në Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit ("**Oda e Veçantë**") përgjithësisht.

Nëse ju keni për qëllim të ankoheni në lidhje me listën e punëtorëve nën **Paragrafin 10 të Rregullores së UNMIKut 2003/13 për Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Paluajtshme Shoqërore** apo të dorëzoni një **Ankesë në lidhje me Likuidimin**, mund të ndodhë që kushtet e përgjithshme të përmendura më poshtë të mos aplikohen në tërësi. Koha dhe procedurat janë të ndryshme në rrethana të tilla. Është përgjegjësi e juaja të sigurohet përputhje me ligjin dhe të gjitha rregulloret tjera të zbatueshme.

1) A ka dallim ndërmjet Formularit për Kërkesa dhe Formularit për Kërkesa në lidhje me Likuidimin?

Po. Formulari i AKM-së për Kërkesa duhet të përdoret për çfarëdo kërkesë në lidhje me pronësinë e ndonjë NSH-je/NP-je apo çfarëdo kërkesë të kreditorëve (pa marrë parasysh a janë të siguruara, të pasiguruara, kërkesë për dëmet, kërkesë për rrogat e papaguara, etj). AKM-ja do ta regjistroj kërkesën dhe do t'ju jap numrin e kërkesës suaj. AKM-ja nuk ka autoritet ligjor të zgjidh apo vendos në lidhje me kërkesën tuaj. Formulari i AKM-së për Kërkesa nuk është i përshtatshëm për kërkesat që kanë të bëjnë me listat e punonjësve sipas nenit 10 të Rregullores për Shfrytëzimin e Tokës.

Formulari për kërkesa në lidhje me likuidimit duhet të përdoret nëse keni ndonjë kërkesë të kreditorit ndaj NSH-së **dhe** pasi që të jetë bërë publikimi i Njoftimit për Likuidim në mediat vendore, ku jepet njoftimi për likuidimin e NSH-së. Më shumë informata për dorëzimin e Formularit të kërkesave në lidhje me likuidimin mund të gjenden në vebfaqen e AKM-së: www.kta-kosovo.org në pjesën "Formulari i Kërkesës për Likuidim".

2) Ku mund të gjej ligjin në lidhje me AKM dhe Odën e Veçantë?

Shiko në vijim www.unmikonline.org

- a) Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/12 për Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, e ndryshuar nga Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/18 (“**Rregullorja e AKM**”);
- b) Rregullorja e UNMIK-ut 2002/13 për Themelimin e Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (“**Rregullorja e Odës së Veçantë**”);
- c) Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2003/13 që implementon Rregulloren e UNMIK-ut 2002/13 për Themelimin e Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (“**UA i Odës së Veçantë**”).

dhe

- d) Rregullorja e UNMIK-ut 2003/13 për të Drejtat e shfrytëzimit të Pronës së Paluajtshme Shoqërore (“**Rregullorja mbi shfrytëzimin e tokës**”).

- 3) **Si duhet të regjistroj kërkesën kundër një Ndërmarrje Shoqërore (NSH) ose Ndërmarrjes Publike (NP), e cila është nën administrim të AKM-së?**
 Nëse keni kërkesë në lidhje me ndonjë NSH/NP nën administrim të AKM, ju duhet të regjistroni kërkesën në AKM duke kompletuar dhe duke dorëzuar në AKM **Formularin e AKM-së për kërkesa**, formë e cila është e bashkangjitur si **Shtojcë A**.

Plotësimi i Formularit të AKM për kërkesa është krejtësisht proces administrativ përmes të cilit AKM regjistron kërkesën ose kërkesën potenciale.

Ju duhet të dini se:

- AKM nuk ka autoritet juridik të zgjidh kërkesën tuaj. Organi i vetëm që është i autorizuar të zgjidh kërkesën tuaj në mënyrë ligjore është ose Oda e Veçantë ose në rrethana të veçanta gjykata e rregullt/lokale; dhe
- Plotësimi dhe dorëzimi i Formës së AKM për kërkesa **nuk** paraqet njoftim sipas neneve 29 dhe 30 të Rregullores së AKM-së (shiqo paragrafin **15** më poshtë) siq nuk ka lidhje me synimin për ndërmarrjen e veprimeve ligjore.

Nëse keni kërkesë apo kërkesë potenciale kundër AKM-së, ju nuk keni nevojë të kompletoni Formularin e AKM-së për kërkesa.

- 4) **Ku mund të gjej Formularin e AKM-së për Kërkesa?**

Forma e AKM për kërkesa mund të gjendet në ZQ të AKM në recepcion ose në Njësinë për Kërkesa – DL në Prishtinë; Zyret Rajonale të AKM-së: në Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Pejë, dhe Gjilan; e poashtu edhe në Zyren e BE-së në Beograd; si dhe vebfaqen e AKM-së: www.kta-kosovo.org në pjesën “Formularët për Kërkesa”.

- 5) **A mund të regjistroj kërkesën kundër disa Ndërmarrjeve duke plotësuar një Formular të AKM-së për kërkesa?**

Nëse dëshironi të regjistroni kërkesa kundër disa Ndërmarrjeve të ndryshme, ju duhet të përdorni Formularin e veçantë të AKM-së për secilën Ndërmarrje.

- 6) **Ku duhet të dorëzoj Formularin e AKM për kërkesa?**

Ju duhet të dorëzoni Formularin e kompletuar të AKM-së me të gjitha dokumentet tjera relevante në cilëndo zyre të AKM-së qoftë në recepcion në ZQ në Prishtinë, në Zyret Rajonale të AKM ose në Zyren e BE-së në Beograd (adresuar në paragrafin 3 të shënuar më lartë).

7) Si duhet të dorëzohet Formularin e AKM-së për Kërkesa në zyret e AKM?

Ju mund të dorëzoni Formularin e plotësuar të AKM për kërkesa me anë të postës, korierit ose personalisht. Ne ju këshillojmë të merrni konfirmimin e pranimit.

8) A duhet të paguaj ndonjë tarifë për regjistrim dhe për dorëzim të Formularit të AKM-së për kërkesa?

Nuk ka nevojë për të paguar tarifa për regjistrim.

9) Në cilat gjuhë mund të plotësohet Formulari i AKM-së për kërkesa?

Në gjuhën Angleze, Shqipe ose Serbe. Ju nuk keni nevojë të dorëzoni formularin në të tri gjuhët.

10) A duhet ta përdori Formularin e AKM-së për kërkesa?

Jo; plotësimi i Formularit të AKM-së për kërkesa nuk është kërkesë ligjore. Megjithatë, rekomandohet që kjo formë e AKM të përdoret sepse siguron se AKM është në dijeni për kërkesën potenciale dhe do të ishte dashur që të sigurojë që ju të mos e harroni ndonjë informatë më rëndësi sa i përket njoftimit të AKM-së rreth kërkesës tuaj potenciale; poashtu do të lejoj AKM-në të procedoj/regjistroj kërkesën tuaj me lehtë.

11) Cila datë konsiderohet si datë e Formularit të AKM-së për kërkesa?

Formulari i AKM-së për kërkesa konsiderohet të jetë regjistruar/pranuar nga AKM në datën e pranimit nga ZQ e AKM, Zyra Rajonale ose Zyra e BE-së në Beograd (nëse dorëzohet personalisht ose përmes korierit) ose data e vulës së postës (nëse dorëzohet me postë).

12) Si mund të di (i) se a është regjistruar Formulari im i kërkesës në AKM dhe (ii) numrin e kërkesës?

Kërkesa e juaj do të regjistrohet në AKM-DL- Njësinë për kërkesa, dhe do të caktohet numri i kërkesës. Ju do të merrni një kopje të Formularit të AKM-së për kërkesa të vulosur nga AKM. Ju lutemi përdorni këtë numër të kërkesës në çfarëdo korrespondence tjetër me AKM në lidhje me kërkesën tuaj potenciale.

Ju lutemi të keni në mend se Oda e Veçantë ka sistem tjetër të numërimit për të regjistruar kërkesat e paraqitura në Dhomën e Veçantë, edhe pse siç është përmendur në këtë dokument kjo është çështje tjetër. Regjistrimi i Formës së AKM për kërkesa në AKM nuk është pjesë e Dhomës së Veçantë ose procedurat e tyre.

13) Çfarë përgjigje duhet të presë prej AKM-së kur të dorëzohet Formularin e plotësuar të AKM-së për kërkesa?

AKM do të caktoj numrin e formularit të kërkesës. Siç është përmendur, AKM nuk gjykon ose nuk merr ndonjë vendim në lidhje me kërkesën tuaj (e cila zakonisht mund të bie nën juridiksion të gjykatës kompetente, nëse ju vendosni të vazhdoni me procedim të çështjes më tej). Është e mundur që

AKM do të mund të ju kontaktoj me ofertë për zgjedhje. Njësia e kërkesave në AKM ka për qëllim t'ju kthejë përgjigje brenda 7 ditësh pas pranimit të formularit; ju lutemi të keni në mend se mund të merr kohë pranimi i formës në njësinë për kërkesa nga ndonjë zyrë tjetër e AKM.

- 14) **Pse duhet të regjistroj Formularin e AKM-së për kërkesa pasi që nuk kërkohet me ligj dhe nëse nuk kërkohet sipas neneve 29 dhe 30 të Rregullores së AKM-së (siç është adresuar në paragrafin 15 më poshtë)?**

Qëllimi i regjistrimit të kërkesës tuaj në AKM është që AKM-ja të informohet për çështjet që kanë të bëjnë me ndonjë NSH apo NP dhe detyrimet e tyre; këto çështje mund të kenë rëndësi të madhe në privatizim për shembull; poashtu është e rëndësishme të lajmërohet AKM se ju keni kërkesë potenciale në lidhje me subjektin në fjalë ashtu që do të ketë të dhëna për interesimin e juaj potencial për NSH apo NP. Poashtu është e mundur që AKM të kontaktojë me ju në rrethana specifike me ofertë për zgjedhje.

- 15) **Përveç faktit se dua të njoftoj AKM rreth kërkesës time ndaj një NSH apo NP, unë dua të padisë NSH, NP apo Korporatën në Odën e Veçantë. Më tej, unë poashtu (si çështje të veçantë) dua të padisë AKM në Odën e Veçantë. Çka duhet të bëj më tej?**

Dorëzimi i Formës së AKM për kërkesa është thjesht njoftim i AKM se ju keni një kërkesë. Kjo nuk ka të bëjë asgjë me veprim ligjor në Odën e Veçantë. Sidomos, nuk paraqet njoftim të synimit të paraqitjes së padisë siç është paraparë në nenet 29 dhe 30 të Rregullores së AKM, siç është cekur më poshtë.

29.1 Asnjë procedurë ligjore kundër një ndërmarrjeje nuk do të mbahet në gjykatë nëse kërkuesi nuk siguron dëshmi me shkrim se Agjencisë i është paraqitur njoftimi me shkrim lidhur me ngritjen e padisë në të cilën duhet të specifikohet emri i kërkuetit, emri i ndërmarrjes ose i korporatës dhe të dhënat e tjera identifikuese, baza e ankesës dhe ndihma e kërkuar.

30.2 Dhoma e Veçantë nuk do të pranojë asnjë padi kundër Agjencisë përveç nëse pala ankuuese dorëzon dëshminë se e ka njoftuar kryesuesin e Bordit për dorëzimin e një padie të tillë së paku gjashtëdhjetë (60) ditë para dorëzimit aktual të saj. Me kërkesën e Agjencisë Dhoma e Veçantë mund të pezullojë hapjen e procedurës së padisë që është bërë kundër Agjencisë për një afat i cili nuk mund t'i kalojë gjashtëdhjetë (60) ditë nga dita e pranimit të padisë së tillë për të mundësuar një zgjidhje miqësore. Nëse keni për qëllim të paditni një NSH/NP/Shoqëri Aksionare

Ju duhet të siguroni njoftim me shkrim AKM në përputhje me nenin 29.1 të Rregullores së AKM. Kompletimi i Formës së AKM-së për kërkesa nuk e përmbush këtë kërkesë të pavarur për të njoftuar AKM-n. Ky njoftim duhet të specifikojë emri i kërkuetit, emri i ndërmarrjes ose i korporatës dhe të dhënat e tjera identifikuese, baza e ankesës dhe ndihma e kërkuar.

Nëse keni për qëllim të paditni AKM

Ju lutemi shikoni paragrafin 16 se kur mund të paditni AKM (siç është paraqitur për NSH/NP/Shoqëri Aksionare). Nëse dëshironi të paditni AKM, ju duhet të siguroni së paku 60 ditë më herët njoftimin me shkrim drejtuar Kryesuesit të Bordit në përputhje me nenin 30.2 të Rregullores së AKM, para

se të paraqitet padia në Odën e Veçantë. Plotësimi i Formës së AKM për kërkesa nuk e përmbush këtë kërkesë të pavarur për të lajmëruar Kryesuesin. Edhe pse në Rregulloren e AKM nuk është e specifikuar, ky njoftim mbi synimin për të paditur AKM-n duhet poashtu të përmbajë emrin e paditësit, emrin e Ndërmarrjes ose Shoqërisë Aksionare e cila do të paditet, bazën e kërkesës, lehtësimin që kërkon paditësi si dhe të dhënat tjera identifikuese që janë relevante.

Një njoftim i tillë duhet të adresohet siç vijon:

Kryesuesit të Bordit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit
Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
Rruga Ilir Konushevcij, Nr. 8
Prishtinë
Kosovë

Ose mund të adresohet në kujdes të AKM në zyrën e UE në Beograd, e në këtë rast duhet të adresohet siç vijon:

Kryesuesit të Bordit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit
Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
UE Shtylla IV Zyra në Beograd,
Tolstojeva 47-49,
11000 Beograd
Serbia

Propozohet që në letra të tilla të shkruhet në fillim "Njoftim sipas nenit 30 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12"

Nëse doni të paditni ndonjë Ndërmarrje ose Shoqëri Aksionare dhe AKM, njoftimet sipas neneve 29 dhe 30 duhet të bëhen me forma të veçanta lajmërimi. Më tej, preferohet që të sigurohen njoftime të veçanta për secilën kërkesë.

Pasi që të përmbushen këto kërkesa, ju duhet të paraqitni padinë në Odën e Veçantë në përputhje me kushtet e Paragrafëve 22 dhe 24 si dhe dispozitat e UA të Odës së Veçantë. Neni 25 i UA të Odës së Veçantë duhet poashtu të konsiderohet kur paraqitet padia në Odën e Veçantë. Përveç tjerash, Oda e Veçantë do të shqyrtojë se a janë respektuar afatet kohore.

16) Mirë, por kur mund të padis AKM në Odën e Veçantë?

Ju duhet të jeni të vetëdijshëm se AKM nuk është i padituri i përshtatshëm në të gjitha rastet e kërkesave kundër NSH-ve, NP-ve dhe Shoqërive Aksionare; paditësi duhet të marr parasysh ligjet e adresuara në paragrafin 1 të shënuar më lartë, për shqyrtim të faktit se a është AKM (në vend të Ndërmarrjes apo Shoqërisë Aksionare) si i paditur i përshtatshëm. Paditësi duhet të marr këshillë juridike sa i përket kësaj çështje.

Derisa shqyrtimi i ligjit në tërësi duhet të bëhet për shkak të këtyre qëllimeve, referenca specifike bëhet ndaj atyre që vijojnë:

- Neni 18 (Obligimet, Vigjilenca dhe Përgjegjësia e Agjencisë) e Rregullores së AKM;
- Neni 29 (Të drejtat e Agjencisë në proceset gjyqësore kundër Ndërmarrjes) e Rregullores së AKM;
- Neni 30 (Paditë kundër Agjencisë) i Rregullores së AKM;

- Neni 4 (Juridiksion) i Rregullores së Odës së Veçantë;
- Neni 5 (Paditësit dhe të paditurit) të Rregullores së Odës së Veçantë

- Neni 6 (Afati për paraqitje të padisë kundër vendimeve ose veprimeve të Agjencisë) të Rregullores së Odës së Veçantë
- Rregullorja mbi Shfrytëzimin e Tokës

17) Cila datë e njoftimit sipas neneve 29 dhe 30 të AKM-së konsiderohet se njoftimi është dorëzuar në AKM?

Edhe pse nuk ka udhëzues direkt për qëllime të njoftimit paraprak 60 ditore sipas nenit 30.2 të Rregullores së AKM, dhe referenca duhet të bëhet sipas parimeve të paraqitura në nenin 8 (Shërbimi Efektiv) të UA të Odës së Veçantë. Me qëllim të largimit të çfarëdo dyshimi apo konfuzioni, është vendosur që periudha 60 ditore do të fillojë të llogaritet kur AKM ka pranuar njoftimin në emër të Kryesuesit.

18) A ka afat për datën e fundit të paraqitjes së padisë në Odën e Veçantë për ti sfiduar vendimet ose veprimet e AKM?

Po. Sipas nenit 6 të Rregullores së Odës së Veçantë, ju duhet të paraqitni padinë për të sfiduar vendimin ose veprimin e AKM me Odën e Veçantë brenda 9 muajve pas:

- a) Datës të cilën e keni ditur ose është dashur të interesoheni të dini vendimin ose veprimin e AKM;
- b) Datës për të cilën Oda e Veçantë ka dhënë lajmërim publik se është në gjendje të pranojë padi. Kjo datë konsiderohet nga Oda e Veçantë të jetë 16 Qershori 2003.

Sigurisht, AKM duhet të njoftohet paraprakisht 60 ditë para datave të dhëna.

Ankesat rreth listës së punëtorëve dhe kualifikueshmërisë për 20% prej privatizimit nën Rregulloren e Shfrytëzimit të Tokës, ju duhet të paraqitni ankesën e juaj në Odën e Veçantë direkt brenda 20 ditësh pas publikimit final në media në listën e punëtorëve të kualifikueshëm nga ana e AKM, siç është kërkuar nga neni 10.6 të Rregullores mbi Shfrytëzimin e Tokës.

Sa i përket Formularëve të Kërkesave në lidhje me Likuidim, ju duhet që këta formularë t'i dorëzoni brenda 2 muajve pas publikimit të Njoftimit të dytë për Likuidimit. Dështimi për të regjistruar Formularin e Kërkesës në lidhje me likuidimin brenda afatit dy mujor do të përjashtojë kërkesën tuaj nga shpërndarja e të ardhurave nga shitja.

19) Mirë, pra poashtu duhet të paraqesë padinë zyrtarisht në Odën e Veçantë (përpos plotësimit të Formës së AKM për kërkesa si dhe lajmërimet e kërkuara nën neni 29 dhe 30 të Rregullores së AKM). Kur dhe ku duhet ta bëjë këtë?

Pasi që keni pritur periudhën e kërkuar për njoftim dhe nëse dëshironi dhe jeni në gjendje të vazhdoni duke u bazuar në shqyrtimin e ligjeve të aplikueshme, atëherë ju duhet të paraqitni padinë tuaj të plotë me evidencë/përkrahje zyrtare të Odës së Veçantë (Shiko nenet 22, 24 dhe 25 të UA të Odës së Veçantë çka së paku duhet te përmban lutja). Nuk ka formë specifike të dokumentit për ta paraqitur në Odën e Veçantë.

20) A më nevojitet ndonjë avokat?

Shiko nenin 21 të UA të Odës së Veçantë. Paditësit dhe të paditurit (të tjerë pos AKM) duhet të paraqiten nga një anëtar i shoqatës së avokatëve në Kosovë ose në Serbi dhe Mal të Zi përveç në rast se personat dëshirojnë të përfaqësojnë vetveten (temë për komentet më poshtë). Gjykatës kryesues i

Odës së Veçantë, mund të lejoj një avokat të huaj i cili ka kompetenca të domosdoshme ose përvojë që të ju përfaqësojë juve.

Me kërkesë të cilësdo palë ose me veprim të Gjykatësit Kryesor, Gjykatësi Kryesor mund të urdhërojë që pala të përfaqësohet nga një anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës ose të Serbisë e Malit të Zi, në rrethana specifike. Ju lutemi merrni parasysh kushtet për asistencë financiare për përfaqësim ligjor, që janë të paraqitura në nenin 21 të UA të Odës së Veçantë.

Nën nenin 21.3 të UA të Odës së Veçantë, cilido avokat i caktuar duhet të paraqesë në Regjistrin e Odës së Veçantë një kopje të autorizimit të avokatit për përfaqësim të palës në proceset para Odës së Veçantë.

Ju nuk keni nevojë për avokat për të plotësuar Formën e AKM për kërkesa ose të njoftoni AKM siç parashihet në nenet 29 dhe 30 të Rregullores së AKM.

Në përgjithësi, edhe pse nuk kërkohet me ligj, AKM do të rekomandonte që ju të angazhoni një avokat për të ju ndihmuar në përgatitjen e lëndës.

21) Sa kopje të lutjes duhet t'i dorëzohet në Odën e Veçantë?

Sipas nenit 22.1 të UA të Odës së Veçantë, ju duhet të paraqitni edhe origjinalin, së bashku me gjashtë kopje për Odën e Veçantë, si dhe kopje për çdo palë tjetër. Shqyrtoni me kujdes nenet 22, 24 dhe 25 të UA të Odës së Veçantë në lidhje me shkresat tuaja iniciuese dhe nenet tjera të zbatueshëm të UA të Odës së Veçantë.

22) Cilat janë rregullat e përkthimeve sa i përket paraqitjes së dokumenteve në Odën e Veçantë?

Sipas UA të Odës së Veçantë, neni 22.7, shkresat dhe dokumentet plotësuese duhet të dorëzohen në Odën e Veçantë në gjuhën Shqipe, Serbe ose Angleze. Megjithatë, nëse dorëzohen në gjuhën Shqipe ose Serbe duhet të dorëzohet edhe versioni në gjuhën Angleze. Përkthimi duhet të bëhet në shpenzime të juaja.

23) Çka nëse nuk ka mjete për të paguar përkthimin?

Sipas neneve 22.8 dhe 22.9 të UA të Odës së Veçantë, ju mund të aplikoni për asistencë së Odës së Veçantë për përkthime nëse mund të demonstroi se me të vërtetë nuk keni mundësi të paguani.

24) Si përgjigjet Oda e Veçantë?

Oda e Veçantë do të ju jap numrin e lëndës (padisë) dhe mund të kërkojë nga ju për dokumente/qartësime të mëtutjeshme.

25) Si vepron më tutje Oda e Veçantë?

Pasi që Oda e Veçantë të ketë pranuar dhe regjistruar padinë, ajo i adresohet Gjyqtarit Raportues të Odës së Veçantë i cili do të vlerësojë lejueshmërinë e padisë dhe do të shikojë se a ka mundësi për ndonjë lehtësim sa i përket kërkesës si çështje e juridike.

Neni 25.2 i UA të Odës së Veçantë paraqet çështjet që duhet të përmbushen ashtu që padia të konsiderohet si e lejueshme. Nëse Gjyqtari Raportues ka vendos se kërkesat e nenit 25.2 nuk janë përmbushur, ai/ajo mund të lëshojë një urdhër për kompletim/korrigjim nga ana e juaj për një periudhë të caktuar. Nëse ju nuk reagoni, atëherë Oda e Veçantë do të refuzojë kërkesën.

Nëse Gjyqtari Raportues ka arritur në përfundim se nuk ka mundësi për lehtësim sa i përket padisë si çështje gjyqësore, atëherë çështja do të adresohet ndaj Odës së Veçantë me rekomandime për refuzim të padisë nën nenin 25.5. Ju do të lajmëroheni për rekomandim të tillë dhe pastaj do të keni 14 ditë në dispozicion që të reagoni ose të paraqitni vërejtje.

Kur padia konsiderohet e lejueshme dhe nuk refuzohet për cilëndo bazë të sipër përmendur, atëherë Gjyqtari Raportues do të dërgojë padinë të paditurit. I padituri ka një muaj për mbrojtje nën paragrafin 26 të UA të Odës së Veçantë. Oda e Veçantë do të analizojë mbrojtjen dhe do të caktojë datat e dëgjimit. Poashtu mund të caktohet data e dëgjimit për të ndërmarrë veprime praktike për tërë rastin në përgjithësi “në seancë përgatitore”.

26) Si mund të njoftohem me rregullat dhe procedurat e Odës së Veçantë?

Ju duhet të shikoni nenin 8 të Rregullores së Odës së Veçantë dhe kapitujt VI, VII, VIII, IX të UA të Odës së Veçantë.

27) Kërkesa ime është urgjente sepse dua të ndalojë një veprim-çka duhet të bëj?

Nëse ju mund të dëshmoni dhe të ofroni fakte se ndonjë lëndim, dëmtim ose humbje e menjëhershme do të shkaktohet ndaj jush nëse nuk lëshohet vendim gjyqësor si mase e përkohshme, atëherë Oda e Veçantë mund të lëshojë vendimin gjyqësor për periudhë të caktuar kohore (që mund të zgjatet me kërkesë). Në këtë instancë, në rrethana specifike, mund të ndodh që AKM të shtyjë kërkesën për AKM, pra të lajmërohet 60 ditë përpara. Ju duhet të prapëseprapë të njoftoni AKM. Shikoni nenin 52 të UA të Odës së Veçantë.

28) Çka nëse ankesa ime ka të bëjë me lista të punëtorëve dhe kualifikueshmërinë për 20% nga të ardhurat e privatizimit, nën Rregulloren e Shfrytëzimit të Tokës?

Këto ankesa nën Paragrafin 10.6 të rregullores për Shfrytëzim të Tokës janë zhvilluar shpejtë. Nëse besoni se ju duhet të jeni në listë ose se duhet të jeni të kualifikuar për të paraqitur ankesë (nën Nenin 10), atëherë ju duhet të paraqiteni në Odën e Veçantë brenda 20 ditësh nga publikimin final i listës së punëtorëve në media nga ana e AKM. Oda e Veçantë do të shqyrtojë çfarëdo ankese si prioritet dhe do të merr vendime mbi ato ankesa brenda 40 ditësh prej datës së dorëzimit. Për shqyrtim të dokumenteve nuk ka mjaft kohë sipas Rregullores për Shfrytëzim të Tokës dhe sipas UA të Odës së Veçantë. Ndodh që në lidhje me ankesat e tilla të mos aplikohen të gjitha kushtet. Ne ju këshillojmë që gjithmonë të aplikoni për këshilla ligjore dhe të referoheni sidomos në Rregulloren për Shfrytëzimin e Tokës dhe Paragrafit 64 të UA të Odës së Veçantë.

29) Ndërmarrja ka ndryshuar emrin dhe nuk e dini emrin e ri të saj? Si duhet ta paraqitni në dokumente?

Ju duhet të paraqitni të gjithë emrat e Ndërmarrjes që ju i dini (për shembull emrat e vjetër Serb ose Shqip); poashtu duhet të paraqitni adresën e plotë të Ndërmarrjes dhe çdo numër regjistrimi të gjykatës ekonomike ose informata të ngjashme që do t'i ndihmojnë AKM dhe Odës së Veçantë të identifikojnë Ndërmarrjen ndaj të cilës paraqitet kërkesa.

30) A mund të paraqes padi në gjykatat tjera të Kosovës?

Sipas rregullores së UNMIKut, Oda e Veçantë ka juridiksion primar mbi lëmit specifike të paraqitura, e sidomos paditë në lidhje me Ndërmarrjet nën juridiksion të AKM. Kjo do të thotë se gjykatat tjera duhet të ndërpresin procedurën e filluar. Më tej, pas paraqitjes së kërkesës nga AKM, në çdo kohë pas fillimit të administrimit të një ndërmarrjeje ose korporate, Dhoma e veçantë mund të tërheqë çdo padi që mbetet e pazgjedhur në ndonjë gjykatë në Kosovë, palë e së cilës është ajo ndërmarrje apo korporatë. Shiko nenet 4 dhe 5 të Rregullores së Odës së Veçantë.

31) Çka është Oda e Veçantë?

Oda e Veçantë është gjykatë e themeluar posaçërisht për shqyrtimin e padive kundër ndërmarrjeve shoqërore dhe publike në Kosovë dhe AKM. Ajo ka 3 gjykatës ndërkombëtar dhe 2 gjykatës banor të Kosovës.

32) A do të caktojë Oda e Veçantë proces të dëgjimit për të gjitha rastet?

Oda e Veçantë ka juridiksion primar për paditë ose kundërpaditë në lidhje me çështjet e paraqitura në nenin 4 të Rregullores së Odës së Veçantë. Po ashtu mund të adreson paditë specifike ose kategoritë e padive në cilëndo gjykatë që ka juridiksion sipas ligjeve të aplikueshme.

33) A lejohet ankesa në Odën e Veçantë?

Në Kosovë nuk ka gjykatë për ankesa ndaj Odës së Veçantë. Kjo është gjykata më e lartë në Kosovë.

34) A mund të paraqesë ankesë prej ndonjë gjykate tjetër në Odën e Veçantë?

Po. Shiko nenet 55, 56 dhe 57 të UA të Odës së Veçantë. Afati është 2 muaj prej vendimit të gjykatës tjetër brenda të cilit duhet të paraqitet ankesa. Poashtu kundër vendimit të gjykatës të cilës i është referuar lënda nga Oda e Veçantë sipas nenit 4.2 të Rregullores së Odës së Veçantë mund të paraqitet ankesë në Odën e Veçantë (dhe vetëm në Odën e Veçantë), përveç nëse Oda e Veçantë vendosë ndryshe.

35) A kam të drejtë kompensimi për shpenzime ligjore?

Po. Shiko nenin 11 të Rregullores së Odës së Veçantë dhe nenin 53 të UA të Odës së Veçantë.